



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2021:128128

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05383407

C.nr.337/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. L., nga fshati P., K. e D., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. K., avokat në P., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Dukagjin Povataj, Avokat Publik Komunal, për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit, me vlerë të kontestit 3.191,52 €, jashtë seance, me datë 27.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. L. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses për periudhën nga data 21.06.2018 e deri më datën 21.01.2021 apo për 31 muaj t'i paguaj diferencën në pagë mbi bazën e kualifikimit (gradës) baçelor, shumën e përgjithshme prej 1.715,85 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 21.06.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 144,00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë për periudhën nga data 21.06.2018 e deri me datën 21.01.2021 shumën prej 544,81 € dhe për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më datën 20.06.2018 shumën prej 930,86 €, apo shumën e përgjithshme prej 1.475,67 €, si e PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, në këtë gjykatë më datë 21.06.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të pagës mbi bazën e kualifikimit, e në të cilën padi ka theksuar se paditësja nga data 01.09.2014 ka filluar punësimin tek institucioni arsimor Sh.F.M.U. "H. e D.", në fshatin G., K.

e D., është e diplomuar në Fakultetin e Edukimit dhe ka kualifikimin bachelor në programin Fillor, respektivisht ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën, ku paditësja gëzon titullin e punës mësimdhënëse Klasore dhe është e licencuar si mësimdhënëse me vendimin numër ... të datës 11.09.2020 dhe duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008 mësimdhënësve me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar i takon kompensim 27 % e pagës bazë dhe me padi ka kërkuar që e njëjta të kompensohet në emër të pagesës për diferencë në pagë për shkak të kualifikimit, me kamat ligjore, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës. I autorizuari i paditëses, me parashtrësën e datës 05.10.2023 ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar që për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 21.01.2021, për 45 muaj paditëses t'i kompensohet shuma prej 3.191,52 €, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes avokatit publik komunal, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si për nga baza po ashtu edhe nga lartësia, po ashtu ka theksuar se e njëjta është e pa lejueshme për shkak të jashtëafatshmërisë dhe parashkrimit. Pretendon se kontrata kolektive nuk është në harmoni me Ligjin e Punës, se Komuna e Deçanit nuk është nënshkruese e kontratës kolektive dhe se e njëjta nuk ka mjete e as linjë buxhetore për kompensimin e kërkesës lëndore dhe se një detyrim i tillë nuk është paraparë as me kontratën individuale të punës, sa i përket jashtëafatshmërisë pretendon se pala paditëse nuk ka shtetur mjetet juridike të brendshme të punëdhënësi për realizimin e të drejtës konform nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, e po ashtu nuk janë marrë as veprime konform nenit 82 të Ligjit të Punës ku parashihet që përmes Inspektoratit të Punës të realizohen kërkesat, thekson se paditësja posedon vendim për përtrirje të licencës, por në shkresa të lëndës mungon licenca bazë, kështu që nuk e kemi të qartë së për çfarë licence bëhet fjalë, por edhe nëse të njëjtës i takon shpërblymi për licencë konform kontratës së vitit 2017 dhe vendimit të qeverisë, kërkesa e tillë veçse është parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen S. L., e lëshuar nga Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Sh.F.M.U. “H. e D.” në fshatin G., K. e D., si mësimdhënëse – mësuese klase. Bazuar në Listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 01.10.2020-31.10.2020 vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 421,00 € dhe në emër të kualifikimit për çdo muaj i është paguar shuma prej 58,32 €, meqenëse e njëjta ka diplomuar me datë 17.07.2009 dhe ka marrë kualifikimin “Bachelor i Programit Fillor”, fakt që vërtetohet

përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Prishtinë, me numër .. e lëshuar me datë 27.04.2011. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës e cila i është përtrirë me vendimin me numër të referencës 10/3, me numër të protokollit ... të datës 16.11.2020, të Inspektoratit të Arsimit SIA në Pejë, me datë 11.09.2020. Gjykata konform nenit 329 paragrafi 1 të LPK, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare të kryerjes së fakultetit dhe ka gradën baçelor dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 21.06.2018 e deri më datën 21.01.2021 apo për 31 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 55.35 € për çdo muaj, apo shuma e përgjithshme prej 1.715,85 €, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 21.06.2018 deri me datë 21.01.2021 të njëjtës nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit prej 55.35 €, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me mungesën e buxhetit, edhe ky pretendim është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata e vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësja nuk është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Vendimi numër 01/33, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e vendimit të lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se padia është parashtruar jashtë afatit nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës dhe se paditësja nuk ka shtetur mjetet juridike gjykata vlerësoj se nuk qëndron ky pretendim, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me kërkesë në para e që afatshmëria e kërkesës vlerësohet në raport me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe atë vetëm me prapësimin e palës dhe po ashtu gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim për shkak të kualifikimit, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensim, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësja.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 22.06.2018 deri me datë 21.01.2021 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 21.06.2021, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditëses iu pranua shumta e shpenzimeve në vlerë prej 144.00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 €, për pagesën e diferencës së taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00, si dhe për përpilimin e padisë shumta prej 104.00 €.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e bashkëngjitura në padi nuk rezulton se paditëses për periudhën nga data 21.06.2018 e deri me datën 21.01.2021, i takon edhe shumta në lartësi prej 544,81 €, mbi shumën

e aprovuar si në pikën I të dispozitivit, pasi që gjykata erdhi në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditëses është saktësisht 421,00 €, bazuar në listën e pagave, andaj gjykata nuk gjeti prova për të vërtetuar kërkesën e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv, ndërsa pretendimet e përfaqësueses ligjore të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i morri pjesërisht si të bazuara dhe atë vetëm sa i përket periudhës kohore prej datës 18.04.2017 e deri më datën 20.06.2018, me lartësi të kërkesës për shumën prej 930,86 €, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën e lartcekur e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 21.06.2021 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për çka gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.337/21, datë 27.02.2023

G j y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.